



Data: 29/07/2019

Ref.: 1382/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

#### V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
  - Biologji, MSc 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik;
  - Matematikë, BSc 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik;
  - Matematikë, MSc 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- II. Obligohet Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### A r s y e t i m i

I. Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore më datë 08.05.2019 me qëllim të vlerësimit në

nivelin institucional dhe të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Vassilis Tsiantos, Prof. Dr. Mladen Krajacic dhe Delia Gologan.


Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtar konstaton se programet e studimit Biologji (MSc), Matematikë (BSc) dhe Matematikë (MSc) të ofruara nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore përmbushin substancialisht standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

